



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 17 shkronja g) dhe në pajtim me nenin 40 shkronja l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjit nr.04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Rregullores (QRK) nr.17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, me theks nenit 12 paragrafët 1.5; 1.6, si dhe nenin 31, neneve 14, 15 paragrafi 2.4, nenin 19 paragrafi 1.7 dhe në pajtim me nenin 34 paragrafi 2.12 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, mori këtë,

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTI PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

Neni 1

1. Me këtë vendim miratohet Raporti përfundimtar nr.prot.01-401/01-0069275/23 datë 18.09.2023 i Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në ekonomi familjare, bujqësi dhe në biznese, përkatësisht vlerësimi i dëmeve sipas Listës së evidentimit të dëmeve bashkëngjitur Raportit.

2. Vlera totale e dëmeve të vlerësuara si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, është **931,272.07 €**, dhe atë sipas fushave në vijim:
- Në Ekonomi familjare **198,285.00 €**
- Në Bujqësi **728,122.87 €**
- Në biznes **4,864.20 €**

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti përfundimtar i Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 3

Nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës, për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe Drejtoritë tjera varësisht nevojave nga fushveprimtaria përkatëse.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren 06/2021.

Nr.Prot. 01-401/04-0071617/23
Podujevë, datë; 27 shtator 2023



Kryeshteshti i Kuvendit
Hëmi Hoxha